

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AKTIN FINAL TË KONFERENCËS SË SHTETEVE ANËTARE TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR STANDARDET E KUALIFIKIMIT, CERTIFIKIMIT DHE SHËRBIMIT PËR DETARËT, (STCW) 1978”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji synon të plotësojë kuadrin ligjor në fushën e kualifikimit, të atestimit dhe të shërbimit për detarët. Konventa përcakton standardet minimale në lidhje me trajnimin, certifikimin dhe mbajtjen e vëzhgimit për detarët, në vendet të cilat janë të detyruara të përmbushin ose tejkalojnë këto standarde.

Një veçori e rëndësishme e Konventës është se ajo është e vlefshme edhe për anijet e shteteve joanëtare kur vizitojnë portet e shteteve që janë palë në Konventë. Neni X përcakton që palët të zbatojnë masat e kontrollit për anijet e të gjithë flamujve në masën e nevojshme për të siguruar që asnjë trajtim më i favorshëm nuk jepet për anijet që kanë të drejtën të mbajnë flamurin e një shteti që nuk është palë sesa u jepet anijeve që mbajnë flamurin e një shteti që është një palë.

Vështirësitë që mund të lindin për anijet e shteteve që nuk janë palë në Konventë është një arsye pse Konventa ka pasur një ratifikim kaq të gjerë nga shtetet. Deri në vitin 2014, Konventa STCW kishte 158 shtete anëtare, që përfaqësonin 98.8 për qind të tonazhit botëror të anijeve.

Objekti i këtij projektligji është miratimi edhe nga Republika e Shqipërisë, si shtet anëtar në IMO, i ndryshimeve të Konventës STCW, miratuar në Konferencën e Manilës në vitin 2010 (2010 Manila Amendments), i cili do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e standardeve kombëtare të nevojshme për institucionet e trajnimit dhe trajnuesit për të zhvilluar aftësitë dhe kompetencat kaq shumë të nevojshme për marinarët e sotëm, duke u bazuar në standardet ndërkombëtare.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë, si më poshtë vijon:

- Përmirësimi i masave për të parandaluar praktikat mashtruese që lidhen me dhënien e certifikatave të kompetencës dhe për të forcuar procesin e vlerësimit;
- Rishikimi i kërkesave për orët e punës e të pushimit dhe kërkesat e reja për parandalimin e abuzimit me drogën e alkoolin, si dhe standardet e përditësuara në lidhje me standardet e përshtatshmërisë mjekësore për detarët;
- Kërkesa të reja të certifikimit për detarët;
- Kërkesa të reja në lidhje me trajnimin në teknologjinë moderne, siç janë tabelat elektronike dhe sistemet e informacionit (ECDIS);
- Kërkesa të reja për trajnimin e paralajmërimit për ndotjen ndaj mjedisit detar dhe trajnimin e drejtuesve të punës në grup;
- Kërkesa të reja të trajnimit dhe certifikimit për oficerët elektroteknikë;
- Përditësimi i kërkesave të kompetencës për personelin që shërben në të gjitha llojet e cisternave, duke përfshirë kërkesat e reja për personelin që shërben në cisternat me gaz të lëngët;
- Kërkesa të reja për trajnimin e sigurisë, si dhe dispozita për të siguruar se detarët janë të trajnuar siç duhet për të përballuar nëse anija e tyre bie nën sulmin e piratëve;
- Futja e metodologjisë së trajnimit modern duke përfshirë mësimin në distancë dhe trajnimin në internet;
- Udhëzime të reja trajnimi për personelin që vepron në sistemin pozicionues dinamik.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje me programin e qeverisë, i cili në kapitullin “Integrimi në Bashkimin Evropian” përcakton se “Zbatimi me korrektësi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), përmbushja e pjesës së mbetur nga 12 prioritetet e planit të veprimit janë elemente kryesore për cilësinë dhe shpejtësinë e procesit të aderimit të Shqipërisë në BE”.

Miratimi i projektligjit është parashikuar si një nga angazhimet e ministrisë përgjegjëse për transportin në Strategjinë Sektoriale të Transportit dhe planin e veprimit 2016-2020, miratuar me vendimin nr.811, datë 16.11.2016, të Këshillit të Ministrave ku në projektin strategjik 1 objektivi 1.1 është përcaktuar “Përmirësimi i sistemit rregullator detar në pajtim me standardet dhe rregulloret

e IMO-së dhe BE-së” dhe veprimi prioritar detar 1 “Ratifikimi dhe nënshkrimi i rregulloreve të IMO-së dhe BE-së mbi sigurinë e parrezikshmërinë detare, mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin bregdetar”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Çelësi për të ruajtur një mjedis të sigurt të transportit dhe për të mbajtur detin të pastër qëndron te të gjithë detarët në mbarë botën, duke respektuar standarde të larta të kompetencës dhe profesionalizmit në detyrat që ata kryejnë në bordin e anijes. Akti final i Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Trajnimit, Certifikimit dhe Atestimit për Detarët, 1978, e ndryshuar në vitin 1995 dhe përsëri në 2010, përcakton këto standarde, rregullon dhënien e certifikatave dhe kontrollon masat për mirëmbajtjen e anijeve. Dispozitat e saj jo vetëm që zbatohen për detarët por edhe për pronarët e anijeve, institucionet e trajnimit dhe administratat kombëtare detare.

Konventa u miratua nga Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO) në vitin 1978 dhe hyri në fuqi në vitin 1984. Gjatë fundit të viteve 1980 ishte e qartë se STCW-78 nuk po arrinte synimin e vet për ngritjen e standardeve profesionale në mbarë botën, kështu që shtetet anëtare të IMO-së vendosën ta ndryshojnë atë. Kjo u bë në fillim të viteve 1990 dhe konventa e ndryshuar quhej atëherë STCW-95.

Amendamentet e Manilës 2010 u miratuan nga rezolutat 1 dhe 2, respektivisht në Konferencën e Palëve të Konventës STCW, të mbajtur në Manila, Filipine, nga 21 deri më 25 qershor 2010 (Konferenca STCW 2010). Ndryshimet përditësojnë standardet e kërkuara të kompetencës, veçanërisht në dritën e ndryshimeve teknologjike, prezantojnë kritere dhe metodologji të reja kualifikimi dhe atestimi, përmirësojnë mekanizmat e zbatimit të dispozitave të saj dhe detajojnë kriteret e orëve të punës dhe të pushimit, parandalimin e abuzimit me drogë dhe alkool, standardet e gjendjes shëndetësore të detarëve dhe synojnë të përfshijnë të gjitha ndryshimet e pranuar që nga viti 1995, të adresojnë teknologji të reja, mospërputhje, interpretime dhe dispozita të vjetëruara.

Ka pasur theks të veçantë në përmirësimin e dispozitave të kontrollit dhe të komunikimit të certifikimit në kapitullin 1 dhe adresimin e kërkesave specifike të anijeve në det të hapur dhe në det të shkurtër. Ka pasur gjithashtu një angazhim të përgjithshëm për të harmonizuar Konventën e ndryshuar të STCW, ku është praktike me dispozitat e Konventës së Punës së Detit të ILO-s, të vitit 2006, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.103/2015.

Ndërsa Konventa STCW-78 u përqendrua pothuajse tërësisht në njohuritë e detarëve, theksi i STCW-95 është zhvendosur në aftësitë dhe kompetencat praktike të mbështetura nga njohuritë teorike. Ndryshimet e vitit 2010 vazhdojnë të theksojnë kompetencën e detarit në vendin e shërbimit ose gjatë periudhës së trajnimit. Standardi i përcaktuar nga Konventa zbatohet për detarët e të gjitha radhëve që shërbejnë në anijet tregtare detare të regjistruara nën flamurin e një shteti anëtar në Konventë.

Konventa STCW tashmë është pranuar nga të gjithë furnizuesit kryesorë të punës dhe regjistrat e anijeve. Kjo përbën më shumë se 98 % e flotës tregtare të botës.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe konkretisht me nenin 121, ku përcaktohet se “Ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë bëhet me ligj në rastet kur ato kanë të bëjnë me miratimin, ndryshimin, plotësimin ose shfuqizimin e ligjeve”, dhe nenin 49 “Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”. Gjithashtu, projektligji është në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 59, “1. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: a) punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë”, ku përcaktohet se shteti brenda kompetencave kushtetuese ka të drejtën dhe detyrimin për të rregulluar marrëdhëniet në punë dhe kushtet e punës.

Projektligji është, po ashtu, në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, ratifikuar me ligjin nr.9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”. Pika 2, e nenit 59, e kapitullit III “Ofrimi i shërbimeve” përcakton se palët angazhohen të respektojnë detyrimet ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e standardeve të sigurisë, të sigurimit dhe të mjedisit.

Neni 100 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit “Arsimi dhe trajnimi” përcakton se “Palët bashkëpunojnë me synim ngritjen e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe trajnimit profesional në Shqipëri”.

Miratimi i projektligjit është në përputhje me Strategjinë Sektoriale të Transportit dhe të planit të veprimit 2016-2020, miratuar me vendimin nr.811, datë 16.11.2016, të Këshillit të Ministrave, ku në projektin strategjik 1 objektivi 1.1 është përcaktuar “Përmirësimi i sistemit rregullator detar në pajtim me standardet dhe rregulloret e IMO-së dhe BE-së” dhe veprimi prioritar detar 1 “Ratifikimi dhe nënshkrimi i rregulloreve të IMO-së dhe BE-së mbi sigurinë, e parrezikshmërinë detare, mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin bregdetar”.

Miratimi i projektligjit bëhet në zbatim të detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO) për aderimin në të gjitha konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë, ndryshimeve të tyre dhe rezolutave të IMO-së për plotësimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e detarisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji bën të mundur aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e Manilës 2010 (*Manila Amendments 2010*) të miratuara me aktin final të Konventës Ndërkombëtare për standardet e kualifikimit, certifikimit dhe shërbimit për detarët” në Manila, Filipine, në datë 25.6.2010, dhe nuk ka përafrim me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Konkretisht ky projektligj përmban, si më poshtë vijon:

1. Tekstin e Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët, 1978, e ndryshuar përfshirë ndryshimet e Manilës 2010”.

Rezoluta 1: Ndryshimet e Manilës në shtojcën e Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët (STCW), 1978;

Rezoluta 2: Ndryshimet e Manilës në Kodin e Kualifikimit, Atestimit dhe Shërbimit të Detarëve (STCW);

Rezoluta 3 Shprehje e vlerësimit për qeverinë pritëse;

Rezoluta 4 Dispozitat kalimtare dhe zbatimimi i hershëm;

Rezoluta 5: Verifikimi i certifikatave të kompetencës dhe miratimet;

Rezoluta 6: Standardet e kualifikimit dhe të certifikimit të niveleve të personelit të anijeve;

- Rezoluta 7: Promovimi i njohurive teknike, aftësive dhe profesionalizmit të detarëve;
- Rezoluta 8: Zhvillimi i udhëzimeve për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të aftësisë shëndetësore për punë të detarëve;
- Rezoluta 9: Rishikim i kurseve të modelit ekzistues të publikuara nga Organizata Ndërkombëtare Detare dhe zhvillimi i kurseve të modeleve të reja;
- Rezoluta 10: Promovimi i bashkëpunimit teknik;
- Rezoluta 11: Masat për të siguruar kompetencën e kapitenëve dhe oficerëve të anijeve që operojnë në ujërat polare;
- Rezoluta 12: Tërheqja e të rinjve në dhe mbajtja e detarëve në profesionin e detarit;
- Rezoluta 13: Akomodimi i stazhierëve;
- Rezoluta 14: Promovimi i pjesëmarrjes së grave në industrinë detare;
- Rezoluta 15: Amendamentet e ardhshme dhe rishikimi i Konventës dhe Kodit STCW;
- Rezoluta 16: Kontributi i Organizatës Ndërkombëtare të Punës;
- Rezoluta 17: Roli i Universitetit Botëror Detar, Instituti Ndërkombëtar i Ligjit Detar i IMO dhe Siguria Ndërkombëtare Detare, Akademia e Sigurisë dhe Mjedisit (IMSSEA) në promovimin e standardeve të zgjeruara detare;
- Rezoluta 18: Viti i detarëve;
- Rezoluta 19: Dita e detarëve.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohen ministria përgjegjëse për transportin detar dhe institucionet në varësi të saj për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projektligji.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji ka si objekt përmirësimin dhe mirëpërcaktimin e detyrave të institucioneve zbatuese. Në zbatim të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”, është përcaktuar se institucioni përkatës për regjistrimin e detarëve që kërkojnë të pajisen me dëshmitë përkatëse quhet sektori i regjistrimit të mjeteve lundruese dhe detarëve. Ky sektor ka për objekt punë zbatimin e Konventës STCW dhe pas miratimit të ligjit do të jetë po ky sektor që do të zbatojë ligjin e ri pa shpenzime

financiare shitesë. Administrata detare, e cila ka në varësi sektorin e mësipërm, do të monitorojë procesin e trajnimit të detarëve të cilët e kanë të detyrueshme të zhvillohen sipas standardeve ndërkombëtare të përcaktuara nga Konventa ku kërkojmë të aderojmë.

Për sa më sipër, duke vlerësuar detyrimet e administratës detare shprehemi se miratimi i këtij projektligji nuk do të sjellë efekte financiare as për buxhetin e shtetit dhe as për detarët, por thjesht do përditësojë kurrikulat e trajnimeve, duke përmirësuar leksionet në përputhje me zhvillimet e reja që kanë ndodhur në fushën e transportit detar nga koha e hyrjes në fuqi të Konventës deri më sot.

KËSHILLI I MINISTRAVE